



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 21.3.1-2016-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË MINISTRISË SË
TREGTISË DHE INDUSTRIË PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31
DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Besa Morina (Udhëheqës ekupe) dhe Shqiponja Krasniqi/Blerina Krasniqi/Veton Misiri, dhe Bekim Mikullovc (Anëtarë ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Emine Fazliu.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	21
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	22
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	25
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	27

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 18.11.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se vlera prej 239,337€ e projekteve në vijimësi ishte regjistruar si pasuri kapitale, duke rezultuar në mbivlerësim të pasurive.


Për më gjerësisht shih pjesën 1.1 të këtij raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Ministren dhe stafin mbështetës për bashkëpunimin e ofruar gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Ministres

Ministrja ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullores MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se vlera në total prej 239,337€ e projekteve në vijimësi ishte regjistruar si pasuri kapitale në SIMFK, dhe se për këtë vlerë janë mbivlerësuar pasuritë kapitale. Rregulla financiare 02-2013 për menaxhimin e pasurive përcakton se *"Pasuritë jo financiare kapitale*

që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim”.

Këto pagesa kanë të bëjnë për projektet “Zhvillimi dhe krijimi i zonave ekonomike” mes MTI-së dhe Komunës së Lipjanit në vlerë prej 85,573€, “Zhvillimi dhe krijimi i zonave ekonomike” mes MTI-së dhe Komunës së Suharekës në vlerë prej 137,139€, si dhe projekti “Rregullimi i infrastrukturës së inkubatorit të biznesit në Drenas” në vlerë prej 16,626€.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i MTI-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë është përgjegjëse për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të MTI-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t’i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MTI-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me rregullën financiare nr.01/2013 dhe me rregullën financiare nr.02/2013;
- Raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë;
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë;
- Raportin e kontratave të nënshkruara të prokurimit;
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€;
- Raportet për faturat e papaguara;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Raporti vjetor i performancës.

Në kontekst të PFV-ve, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Çështjet e ngritura në Memorandumin e Auditimit, të datës 20.12.2016, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga menaxhmenti.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale. Gabimet e identifikuara të theksimi i çështjes nuk e modifikojnë opinionin e auditimit.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjen e sipërpërmendur me lartë ne japim rekomandimin si në vijim:

Rekomandimi 1 Ministrja duhet të siguroj se janë marrë masat dhe veprimet e nevojshme për të përmirësuar gabimet e identifikuara në theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, projektet të cilat janë në vijimësi duhet të regjistrohen si investime në vijim, dhe pas finalizimit të projekteve të bëhet bartja e pronësisë sipas marrëveshjeve të nënshkruara.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MTI-in që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga MTI siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ne vlerësojmë progresin e bërë të MTI-së sa i përket raportimit menaxherial dhe llogaridhënies. Niveli i mirë i zbatimit të rekomandimeve të vitit paraprak, është tregues për avancimin e mëtutjeshëm të proceseve nga ana e menaxhmentit të MTI-së. Më tutje, për vitin 2016 nuk kishte regjistër të rreziqeve, mirëpo në nëntor të 2016 menaxhmenti kishte formuar grupin punues për hartimin e regjistrit të rreziqeve si dhe planin për menaxhimin e tyre për vitin 2017. Gjithashtu Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi funksionimin e kontrolleve të brendshme, për të cilat kishte dhënë edhe rekomandime për përmirësim.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 ka rezultuar me dhjetë (10) rekomandime. MTI kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar ndërsa katër (4) janë në proces të zbatimit.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 2 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** MTI ka bërë progres në zbatimin e rekomandimeve, megjithatë mos zbatimi i plotë i të gjitha rekomandimeve ka ndikuar që disa mangësi të përsëriten nga viti i kaluar. Kjo ishte e evidente te menaxhimi i burimeve njerëzore si dhe te regjistrimi i pasurisë.
- Rreziku** Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta, të cilat mund të ndikojnë në dobësi në menaxhimin financiar dhe të kontrolleve.
- Rekomandimi 2** Ministrja duhet të sigurojë se janë analizuar shkaktarët e mos zbatimit të plotë të rekomandimeve, si dhe të përcaktoj një afat të ri kohor për zbatimin e tyre, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrolleve. Ky plan duhet të monitorohet në vazhdimësi.

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësit të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në MF, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësit.

Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MTI më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë (5) komponentët e tij. Bazuar në këtë konstatim se:

- Pyetësi i vet-vlerësimit i plotësuar nga MTI, kishte paraqitur gjendjen e saktë të organizatës dhe ishte përcjelle me dëshmitë përkatëse;
- MTI kishte planin vjetor për vitin 2016 i cili ishte i mbështetur mbi Programin Kombëtar për zbatimin e MSA (dhjetor 2015) si dhe strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (janar 2016); dhe
- MTI për vitin 2016 nuk kishte hartuar planin për menaxhimin e rreziqeve, mirëpo në nëntor të vitit 2016, menaxhmenti kishte ndërmarr masa duke formuar grupin punues për identifikimin/vlerësimin e rreziqeve, i cili grup në mars të vitit 2017 kishte finalizuar planin për menaxhimin e rreziqeve si dhe planin për monitorimin e rreziqeve.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.2.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Në kuadër të MTI-së funksionojnë Agjencitë Ekzekutive, si: Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (AIPNK), Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve (ARBK), Inspektorati i Tregut (IT), Agjencia e Pronësisë Industriale (API), Agjencia e Metrologjisë së Kosovës (AMK), Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS) dhe Drejtoria e Akreditimit të Kosovës DAK. Këto agjencione nuk përgatisin pasqyra financiare të ndara nga MTI. Agjencitë kanë strukturën e vet menaxheriale, përmes të cilës organizohet menaxhimi i aktiviteteve të përditshme operative. Megjithatë ato kryejnë aktivitete operative të natyrave specifike për të cilat i raportojnë drejtë për drejtë Ministrit. Raportimet e drejtorëve të departamenteve tek Sekretari i Përgjithshëm janë javore dhe të rregullta. Procesi i konsolidimit të raporteve financiare funksionon mirë gjë e cila ka rezultuar edhe tek cilësia e PFV-ve.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.2.2 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) është pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm. Ne marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit (KA). Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë dhe KA si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm.

NjAB operon me dy (2) anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së dhe një (1) auditor. Për vitin 2016, kjo njësi kishte planifikuar pesë (5) auditime të cilat i kishte finalizuar. Po ashtu përveç realizimit të planit NjAB kishte kryer edhe një (1) auditim me kërkesë të menaxhmentit.

Në raportet e auditimit të brendshëm ishin dhënë gjithsej 22 rekomandime. Prej tyre 18 ishin zbatuar, ose 82%.

KA gjatë vitit kishte mbajtur katër (4) takime, në të cilat ishte mjaftë aktiv në diskutimin dhe adresimin e çështjeve të dala nga raportet e NjAB-së dhe nga raporti i auditimit i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy (2), pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

MTI në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Në vitin 2016, MTI ka përdorur 98% të buxhet final, një shpenzim me i lartë në raport me vitin paraprak për 1%. Në kontekst të sistemeve financiare, MTI kishte vendos kontrolle të mira edhe të menaxhimi i subvencioneve, si dhe te menaxhimi dhe raportimi i obligimeve.

Edhe përkundër përmirësimeve në fushat e lartcekura, veprime shtesë nevojiten në menaxhimin e burimeve njerëzore, kryesisht me mbulimin e pozitive menaxhuese me Ushtues Detyre (U.D) për një kohë të gjatë si dhe mos harmonizimin e pagesave të zyrtarëve për pozitat e njëjta me kompensim të njëjtë. Mangësi kishte edhe në regjistrimin e pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,447,000	1,447,000	2,287,813	1,887,894	1,707,058
Totali	1,447,000	1,447,000	2,287,813	1,887,894	1,707,058

Të hyrat e mbledhura nga MTI në vitin 2016 ishin në total prej 2,287,813€, dhe se krahasuar me vitin paraprak ka rritje të të hyrave për 399,919€ apo 21%. Ndërsa realizimi i të hyrave në raport me planifikimin e tyre ishte për 58% më i lartë.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	5,097,278	4,652,335	4,557,724	4,731,018	4,876,578
Granti i Qeverisë -Buxheti		4,651,810	4,557,199	4,730,493	4,876,578
Donacionet e jashtme ³		525	525	525	0

Buxheti final në raport buxhetin me fillestar është më i ulët për 444,943€. Ky zvogëlim është rezultat i rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2016, MTI ka përdorur 98% të buxhetit final ose 4,557,724€, me një përmirësim prej 1% krahasuar me vitin 2015. Realizimi i buxhetit ishte në nivel të kënaqshëm.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	5,097,278	4,652,335	4,557,724	4,731,018	4,876,578
Pagat dhe Mëditjet	1,493,233	1,493,233	1,402,343	1,313,025	1,309,367
Mallrat dhe Shërbimet	1,744,765	1,199,299	1,198,814	1,432,027	1,649,701
Shërbimet komunale	109,280	58,030	55,794	84,516	87,673
Subvencionet dhe Transferet	1,050,000	1,275,893	1,274,893	1,106,535	973,000
Investimet Kapitale	700,000	625,880	625,880	794,915	856,837

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final i kategorisë paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar nuk kishte asnjë ndryshim, përderisa realizimi ishte në masën prej 94%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 545,466€. Ky zvogëlim është rezultat i rishikimit të buxhetit për 11,394€, i shkurtimeve buxhetore me vendime të Qeverisë në vlerë prej 427,153€ si dhe transferit të mjeteve në subvencione dhe transfere dhe për mbulimin deficitar të buxhetit në ARBK dhe API, në vlerë prej 106,919€. Realizimi i buxhetit final ishte 100%;
- Zvogëlim të buxhetit final në raport me buxhetin fillestar kishte edhe në kategorinë e shërbimeve komunale në vlerë prej 51,250€. Kjo vlerë ishte transferuar te kategoria e subvencioneve;

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Donacione të jashtme- UNDP

- Buxheti final për subvencione dhe transfer krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 225,893€. Kjo rritje ka rezultuar me vendime të Qeverisë. Mjetet e ndara për këtë kategori janë shfrytëzuar pothuajse 100%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 74,120€ me vendime të Qeverisë. Programi për Investime Publike (PIP) kishte përfshirë të gjitha projektet të cilat ishin në vazhdim nga viti i kaluar. Dy projekte⁴ ishin finalizuar gjatë vitit. Ndërsa projektet që kishin të bënin me ndërtimin e zonave ekonomike përkundër progresit ende nuk ishin finalizuar. Vonesa kishte në realizimin e planit dinamik nga ana e OE për të cilat MTI kishte aplikuar ndëshkimet në pagesa. Buxhetit final për investimet kapitale ishte shpenzuar në tërësi.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime për këtë fushë.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MTI në 2016 ishin në vlerë 2,287,813€, krahasuar me vitin e kaluar kemi një rritje prej 21%. Në rritjen e të hyrave ka ndikuar kryesisht e hyra e veçantë - ekzekutimi i vlerës prej 500,000€ në emër të sigurimit të Tenderit "Zhvillimi dhe Operimi i Projektit për Zhvillimin e Rezortit të Brezovicës" si shkak i mos përmbushjeve të kushteve paraprake të përcaktuara në marrëveshje. Ndërsa në kuadër të të hyrave të rregullta, të hyrat më të larta janë grumbulluar nga regjistrimi i pengut në vlerë prej 668,748€, nga licencat për shërbime profesionale 373,721€ si dhe nga licencat për shitje me pakicë të naftës dhe derivateve në vlerë prej 234,150€.

Nga mostrat e testuara për marka tregtare dhe patenta nuk identifikua vonesa në marrjen e vendimeve.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhën përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe në këtë proces kanë dëshmuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara në PFV-të e MTI-së. Buxheti i ndarë për këtë kategori ishte shpenzuar 94%. Përkundër masave të marra në forcimin e kontrolleve, MTI duhet të vazhdojë edhe më tutje të shtoj kontrollat për të evituar mbulimin e pozitave udhëheqëse me U.D përtej afateve ligjore, si dhe të sigurojë pagesën e stafit në pajtim me akt-emërimet përkatëse. Testet tona kanë identifikuar mangësitë në vijim:

⁴ Projekti "Blerja e laboratorit mobil" dhe projekti "Pajisja me etalon dhe pajime tjera matëse".

Çështja 3 – Dobësi në menaxhimin e Burimeve Njerëzore – Prioritet i lartë

- E gjetura** Një numër i zyrtarëve për pozita të njëjta ishin kompensuar me koeficiente të ndryshëm. Rastet e identifikuara janë si në vijim:
- *Asistentët administrativ* - në gjashtë (6) raste paguhen me koeficient 5, ndërsa në katër (4) raste me koeficient 6;
 - *Të punësuarit si zyrtarë* - në pesë (5) raste paguhen me koeficient 6, në 34 raste me 7, ndërsa në katër (4) raste paguhen me koeficient 7,5;
 - *Zyrtarët e lartë* - në katër (4) raste paguhen me koeficient 7, në tre (3) raste me koeficient 7.5, ndërsa në 27 raste me koeficient 8;
 - *Udhëheqësit e sektorëve* - në një (1) rast paguhen me koeficient 7, një (1) rast me koeficient 7.5, në tri (3) raste me koeficient 8, ndërsa në gjashtë (6) raste me koeficient 9;
 - *Udhëheqës i Drejtoratit* - në një (1) rast paguhet me koeficient 9; ndërsa në një (1) rast tjetër paguhet me koeficient 10; dhe
 - *Drejtori i Drejtoratit* - në katër (4) raste paguhen me koeficient 9.5 dhe në një (1) rast paguhet me koeficient 10.

Për me tepër, MTI, nuk ka arritur të harmonizojë numrin aktual të stafit në departamente me numrin e stafit të aprovuar sipas Ligjit të Buxhetit. Ligji i buxhetit për vitin 2016 përcakton buxhetin si dhe numrin e të punësuarve për secilin departament apo agjenci. Katër (4) zyrtarë të departamenteve të ndryshme paguheshin nga kodet buxhetore të departamenteve tjera.

- Rreziku** Mos harmonizimi i pagesave të zyrtarëve për pozitat e njëjta me kompensim të njëjtë ndikon në cilësinë e punëve të kryera nga zyrtarët përkatës dhe në arritjen e objektivave të organizatës si tërësi. Më tutje, mos harmonizimi i numrit të stafit nëpër departamente rrezikon në cilësinë e punëve të kryera si dhe mbi shpenzim të llogarive në departamentet përkatëse.

- Rekomandimi 3** Ministrja duhet të sigurojë që numri dhe shpërndarja e stafit brenda institucionit është në përputhje me limitet e lejuara sipas programeve të parapara me Ligjin e Buxhetit. Po ashtu të siguroje se pagesa e zyrtarëve bëhet sipas përshkrimit të detyrave të punës.

Çështja 4 - Mbulimi i pozitave menaxheriale me U.D - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas Ligjit për Shërbimin Civil neni 30 “Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, U.D. nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj”. Në tri (3) raste ne identifikuam se pozitat janë mbuluar me U.D. më gjatë se tre (3) muaj, si:
- Pozita *Udhëheqës i Divizionit të Turizmit*, mbulohej me U.D. që nga dt. 20.07.2015. Situata e njëjtë ishte edhe te pozita e *Udhëheqësit të Sektorit për Zhvillimin e Zonave Ekonomike* në AIPNK e cila mbulohej me U.D. që nga data 17.05.2016, dhe vazhduar me vendim të dt.25.08.2016 për zyrtarin e njëjtë. Këto pozita vazhdojnë të mbulohen me U.D. edhe në vitin 2017, përkatësisht deri muajin prill, në kohën sa ishim në auditimin final; dhe
 - Pozita *Menaxher i Prokurimit*, mbulohej me U.D. që nga dt. 10.05.2016 me të njëjtin zyrtar. Përndryshe kjo pozitë mbulohej me U.D. që nga 2013 përkundër përpjekjeve që janë bërë për shpalljen e rekrutimeve në vitin 2014 dhe 2015. Megjithatë, për këtë pozitë në fund të vitit 2016 është bërë përzgjedhja e zyrtarit të rregullt sipas konkursit.
- Rreziku** Praktika e mbulimit të pozitave menaxheriale me U.D mund të ketë efekt negativ në marrjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies në punë, e krejt kjo reflektohet edhe në menaxhimin jo efektiv të MTI-së, si dhe mund të ndikojë edhe në performancën e organizatës në përgjithësi.
- Rekomandimi 4** Ministrja duhet të ndërmerre veprime për të ndërprerë praktikën e mbulimit të pozitave me U.D, si dhe të iniciohen procedurat e rekrutimit në mënyrë që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta sipas afatit të përcaktuar ligjor.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 1,199,299€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,198,814€. Shpenzimet kanë të bëjnë kryesisht me shërbimet kontraktuese, shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit, blerja për rezerva shtetërore si dhe shpenzime tjera.

Ndërsa buxheti final për shërbime komunale ishte 58,030€ i cili ishte shpenzuar 96%. Bazuar në testet tona konkludojmë se MTI kishte vendosur kontrolleve efektive në menaxhimin e tyre.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final në vitin 2016 për subvencione dhe transfere ishte 1,275,893€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,274,893€, ose afro 100%. Shpenzimet në këtë kategori kanë të bëjnë kryesisht me subvencionimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në vlerë prej 1,000,000€. Ndërsa pjesa tjetër është shpenzuar për mbështetjen e ndërmarrjeve kosovare në panairë të ndryshme të organizuara brenda dhe jashtë vendit. MTI përmes udhëzimit administrativ nr.03/2016 ka përcaktuar kritere të qarta në përzgjedhjen e përfituesve të subvencioneve si dhe në monitorimin e tyre. Kjo i ka ndihmuar që të ketë kontrolle në dhënien e subvencioneve dhe shfrytëzimin e parasë publike në mënyrë racionale.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 625,880€, i cili ishte shpenzuar në tërësi. Shpenzimet ndërlidheshin kryesisht me realizimin e projekteve të cilat ishin vazhdim nga viti 2015. Nga testimi i mostrave në procesin e prokurimeve dhe pagesave nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e pasurisë kapitale e MTI-së dhe agjencive të saja vartëse për vitin 2016 është 14,805,000€. MTI kishte formuar dy komisione, atë për inventarizimin e pasurisë dhe komisionin për vlerësim të pasurisë.

Çështja 5 – Dobësi në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë - Prioritet i lartë

E gjetura	<p>MTI, që nga muaji maj i vitit 2016, nuk ka arritur të mbuloj pozitën <i>Zyrtar i Pasurisë</i>. Kjo ka shkaktuar shumë vështirësi në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë të shpalosura si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • MTI kishte themeluar komisionin për inventarizim, mirëpo ky komision nuk kishte arritur të përfundojë raportin brenda afatit të përcaktuar kohor. Si pasojë nuk ishte bërë ndërlidhja e shënimeve nga raporti i inventarizimit dhe SIMFK-së, e cila kishte ndikuar që pasuritë e shpalosura në PFV të mos jenë të sakta. MTI po ashtu kishte themeluar edhe komisionin për vlerësim të pasurisë, mirëpo nuk ka dëshmi të punës dhe as raport përfundimtar për të reflektuar punën e tij; dhe • MTI nuk kishte regjistruar në SIMFK pasurinë “Kontejner për shfrytëzimin e saj si depo” në vlerë 2,230€ i blerë në vitin 2016.
Rreziku	Mungesa e kontrolleve në menaxhimin e pasurisë dhe mos regjistrimi i saj sipas rregullave mund të shpie në humbjen, në keqpërdorim si dhe përdorim të paautorizuar të tyre. Mos regjistrimi i të gjitha pasurive ndikon në cilësinë e shënimeve të shpalosura në PFV.
Rekomandimi 5	Ministrja duhet të sigurojë që brenda një periudhe sa më të shkurtër kohore të rekrutojë Zyrtari i Pasurisë, si dhe të sigurojë se komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë, të përfundojnë punën e tyre dhe raportojnë me kohë në mënyrë që vlera e pasqyruar në PFV të jetë e plotë dhe e saktë.

3.2.2 Te arkëtueshmet

Të hyrat e pa arkëtuara që nga viti 2009 deri në vitin 2016 arrijnë në vlerë 202,118€. Prej tyre të arkëtueshmet vetëm për vitin 2016 ishin në vlerën prej 109,308€, prej të cilave 45,410€ ishin për shërbimet e ofruara ndaj subjekteve nga Agjencioni i Metrologjisë dhe 63,898€ nga qiraja e bizneseve që operojnë në Parkun e Biznesit në Drenas (PBD).

Të arkëtueshmet nga qiraja e bizneseve në PBD ishin trajtuar nga menaxhmenti i MTI-së, duke i paralajmëruar subjektet afariste që operojnë aty se, mos kryerja e obligimeve do të rezultojë me shkëputje të kontratës deri te kallëzimi në gjykatë.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Obligimet

Pasqyra e obligimeve në fund të vitit 2016 ishte 30,010€, që krahasuar me vitin paraprak kishte një rënie për 30% (në fund të vitit 2015 vlera e obligimeve ishte 43,157€). Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017.

Ne kemi testuar disa fatura për të parë nëse ishin raportuar me kohë si obligime dhe nuk kemi rezultuar me ndonjë të parregullsi.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministria duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Ministrja duhet të sigurojë që ka aplikuar një proces formal të monitorimit të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga AP, me qëllim që të mbaj llogaridhënës stafin përgjegjës për adresimin e rekomandimeve sipas afateve kohore të përcaktuara në planin e veprimit.	Po		
2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së	Ministrja duhet të sigurojë se aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.	Po		
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Ministrja duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar. Më tutje, krahas regjistrit të rreziqeve duhet të përpiloj edhe planin aksional për monitorimin e gjasës së ndodhjes së atyre rreziqeve dhe ndërmarrjen e masave për ti sjell në kufirin e pranueshëm. Kjo do të evitonte pengesat potenciale në arritjen e objektivave të ministrisë.		Për vitin 2016 nuk ishte hartuar regjistri i rreziqeve, mirëpo në nëntor 2016 është formuar grupi punues dhe kanë hartuar regjistrin e rreziqeve, përfshirë edhe planin për monitorimin e tyre për vitin 2017, i cili ishte finalizuar në mars 2017.	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Ministrja duhet të sigurojë se do të bëhet një rishikim i proceseve për menaxhimin e personelit dhe sistematizimin e të punësuarve sipas përvojave adekuate për të siguruar respektimin e rregullave në fuqi dhe përfitimin më të mirë nga kapacitet ekzistuese njerëzore në kuadër të MTI-së.		Gjatë vitit 2016 nuk ishin zgjidhur të gjitha kontesteteve dhe ankesave.	

3.4 Prokurimi	Ministrja duhet të analizoj shkaqet që kanë çuar në vonesën e kryerjes së punimeve, dhe të sigurojë se të gjitha projektet e kontraktuara menaxhohen me kohë, në të kundërtën të aplikoj ndëshkimet.	Po		
3.5.2 Kompensimet (paga dhe mëditje)	Ministrja duhet të sigurojë se të gjitha pagesat për paga dhe mëditje bëhen në përputhje me përshkrimin e detyrave të punës dhe për përfituesit e fondit të kuadrove të aplikojë rregulloren në fuqi. Po ashtu duhet të siguroj se numri dhe shpërndarja e të punësuarve brenda departamenteve të organizatës është në përputhje me Ligjin e buxhetit.		Fondi për kuadro nuk ishte aplikuar gjatë vitit 2016, përderisa ende kishte mospërputhje mes pagesës dhe në shpërndarjen e punësuarve sipas departamenteve.	
3.6 Subvencione dhe transfere	Ministrja duhet të sigurojë se vendimi për dhënien e subvencioneve merret pasi të zotohen mjetet e mjaftueshme për pagesën e tyre, përfituesit përzgjidhen në bazë të kriterëve specifike dhe të qarta dhe duke ndjekur një proces të hapur dhe transparent.	Po		
3.7 Të Hyrat	Ministrja duhet të siguroj se janë nxjerrë aktet nënligjore të cilat përcaktojnë qartë afatet kohore për shqyrtimin/ aprovimin e kërkesave për patenta. Shqyrtimi i kërkesave nga subjektet afariste brenda afateve të caktuara ligjore do të parandalonte zhvillimin e veprimtarive pa patenta në sektorin privat.	Po		
3.8.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministrja duhet të sigurojë se janë ndërmarrë hapa konkretë për sigurimin e një depoje dhe për përgatitjen e raportit të inventarizimit me kohë në mënyrë që të ketë kontrolle adekuate rreth pasurisë së MTI-së.		Depoja ishte siguruar për pasuritë të cilat nuk janë në përdorim, mirëpo raporti i inventarizimit nuk ishte përfunduar me kohë.	
3.8.2 Trajtimi i borxheve	Ministrja duhet të sigurojë se çdo faturë e cila pranohet në MTI kalon përmes protokollit për të shmangur rrezikun e vonesës në kryerjen e obligimeve.	Po		

Shtojca IV: Letërkonfirmimi





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Data: 01.06.2017, Prishtinë

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft-raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Agron Maxhuni
U.D. Sekretar i Përgjithshëm në MTI